



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1862/3 Prot

Rrëshen më, 03 . 06 . 2024

V E N D I M

Nr. 43 datë 03. 06. 2024

PËR
“DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK”,
BASHKIA MIRDITË.

Mbështetur në nenin 48, pika 6, gërma b) e ligjit 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", këshilli bashkiak, mbështetur në *proces – verbalin nr. 1862/1 prot, datë 29.05.2024*, të Komisionit Mandateve dhe Çeshtjeve Juridike, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, pas shqyrtimit në seancë të mbledhjes së këshillit bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Mirditë;

▪ Z. Nikolin Prend LULI

Ky vendim, hyn në fuqi menjëherë!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I MANDATEVE DHE ÇESHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1862/2 Prot

Rrëshen më, 29 . 05 . 2024

PROCES - VERBAL

I KOMISIONIT MANDATEVE DHE ÇESHTJEVE JURIDIKE, PËR VERIFIKIMIN E MANDATIT, TË KANDIDATIT PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK, Z. NIKOLIN PREND LULI

I mbajtur sot, e **Mërkurë**, datë **29. 05. 2024**, ora **12³⁰** në mbledhjen e komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike për verifikimin e mandatit për anëtar të këshillit bashkiak Mirditë.

Komisioni i Mandateve dhe Çeshtjeve Juridike i përbërë nga;

1. Z. Mark GJOKA, kryetar i komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike,
2. Z. Aleksandër LUSHA, zv.kryetar i komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike,
3. Z. Ndue HALILI, anëtarë i komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike,
4. Z. Ertor NDREU, anëtarë i komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike,
5. Znj. Brixhilda NOKA, anëtarë i komisionit mandateve dhe çeshtjeve juridike.

Komisioni pasi u njoh me shkresën e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, nr. 1218 datë 08.05.2024, "Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit" dhe Vendimin nr. 43, datë 2.5.2024, "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" **Z.Nikolin Prend LULI, VENDOSI**; plotësimin e vakancës në Këshillin Bashkiak Mirditë. Si rrjedhojë komisioni në mbledhjen e tij mori vendim, për dhënie mandati **dhe konfirmon në bazë të dokumentacionit, se është në përputhshmëri të plotë me ligjin**, si dhe relaton proces-verbalin në seancë të këshillit bashkiak për votim:

- ✚ Morën pjesë në mbledhje; 3 (TRE) anëtarë.
- ✚ Nuk morën pjesë në mbledhje; 2 (DY) anëtarë.
- ✚ Vertetohet vlefshmëria e mandatit; **1 (një)** anëtarë.

Vertetohet mandati emër për emër. Mbas votimit të Anëtarëve të Këshilli Bashkiak dhe betimit, i jep mandatin: **Z. Nikolin Prend LULI**

Bashkëlidhur proces-verbalit të komisionit, shkresa nr. 7109 prot, datë 05.10.2023, së bashku vendimi i KQZ.

ANËTARË

ZV. KRYETAR KRYETAR

Brixhilda NOKA Ertor NDREU Ndue HALILI

Aleksandër LUSHA Mark GJOKA

Konc. Sekretar i Këshillit Bashkiak, Jurist; Gaspër TOPOLLAJ

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

G. ROBOVASI
Dhurat
on

Nr. 1862 Prot
Dt. 12.05.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



Tiranë më 8.5.2024
Nr. 1218 Prot.

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË ✓

Sheshi "Abat Doçi", Rrëshen

Për dijeni: Partisë Social Demokrate

Rruga "Skënderbej", Blloku i Ambasadave, Tiranë

Z. Nikolin Prend Luli

Arrëz Kaçinar, Mirditë

Të nderuar,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 2.5.2024, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mirditë, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Social Demokrate, z. Nikolin Prend Luli.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr.43 datë 2.5.2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

VII-MERKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2.5.2024

Nr: 43

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MIRDITË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË
SOCIALDEMOKRATE", Z. NIKOLIN PREND LULI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4697 prot., datë 13.12.2023, Këshilli i Bashkisë Mirditë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Dava Zef Simoni, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore Partisë Socialdemokrate, për Këshillin e Bashkisë Mirditë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 6, z. Nikolin Prend Luli.

Me shkresën nr. 909 prot., datë 4.04.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Mirditë, z. Nikolin Prend Luli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 2.5.2024 Nr: 43
Ora: 11:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate", z. Nikolin Prend Luli".

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të Partisë Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PSD-23023-1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Nikolin Prend Luli, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 986 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr.985 prot., datë 12.04.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Nikolin Prend Luli.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Nikolin Prend Luli, në Këshillin e Bashkisë Mirditë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.6370/1 prot., datë 17. 04. 2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Nikolin Prend Luli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Nikolin Prend Luli, në Këshillin e Bashkisë Mirditë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 2.5.2024 Nr: 43
Ora: 11:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate", z. Nikolin Prend Luli".

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate, z. Nikolin Prend Luli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 2.5.2024 Nr: 43
Ora: 11:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate", z. Nikolin Prend Luli".